



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°8/2021

Hagë, 04/11/2021

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t’ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Në seancën paraprake që u mbajt të premten e shkuar në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Prokurorinë që të dorëzonte dosjen paraprake brenda datës 17 dhjetor. Dosja paraprake përmban një përmbledhje të provave që Prokuroria synon të paraqesë kundër të akuzuarve në lidhje me secilën nga akuzat.

Të martën dhe të mërkurën e kësaj jave, Prokuroria thirri dëshmitarin e pestë në çështjen e Salih Mustafës , për të dëshmuar rreth organizimit dhe strukturës së UÇK-së në zonën e Zllashit dhe rrethinat. Dëshmitari dëshmoi me masa mbrojtëse, ku përfshihet ndryshimi i zërit dhe fytyrës, dhe iu drejtuan pyetje nga Prokuroria, mbrojtësja e viktimave, Mbrojtja dhe gjykatësit e Trupit Gjykues.

Gjykimi ndaj Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt vazhdon sot dhe nesër me dëshminë e dëshmitarit të tretë, punonjës i ZPS-së, që e nisi dëshminë të enjten e shkuar. Dëshmitari ka dhënë dëshmi rreth kontakteve të tij me personat të cilëve iu përmenden emrat në dokumentet që pretendohet së kanë publikuar të akuzuarit. Ditën e hënë, Trupi Gjykues miratoi kërkesën e ZPS-së për të thirrur edhe një dëshmitar të katërt. Edhe ky dëshmitar është punonjës i ZPS-së dhe parashikohet të fillojë me dhënien e dëshmisë ditën e premte. Të dy këta dëshmitarë do të dëshmojnë pa masa mbrojtëse.

Ndër lajme të tjera: ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara të Kosovës përmes internetit mbajti një ligjëratë për studentët e

1





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°8/2021

Hagë, 04/11/2021

juridikut në Prishtinë dhe iu përgjigj pyetjeve të ndryshme mbi Gjykatën dhe procedurat e saj.

Dhomat e Specializuara kanë organizuar aktivitete të ngjashme ndërgjegjësuere në gjithë Kosovën qoftë fizikisht dhe përmes internetit, me qytetarët e saj, të rinjtë, shoqërinë civile, etj., për t'u dhënë informacion rreth Gjykatës, për të dëgjuar komentet dhe shqetësimet e pjesëmarrësve si dhe për t'u përgjigjur pyetjeve.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

